

## Informacione për COVID-19 (28.08.2020)



### 1. INFOMACIONE PËR PERSONAT E KTHYER NGA UDHËTIMI

EGZISTON NJË **OBLIGIM TESTIMI** PËR PERSONAT, QË HYJNË NGA ZONAT E RREZIKUARA. PËRSA KOHË NUK PARAQITET ASNJË REZULTAT NEGATIV I TESTIT, UDHËTARËT HYRËS NGA ZONAT E RREZIKUARA DUHET TË FUTEN NË KARANTINË 14 DITORE.

Nëse Nëse ktheheni në Mannheim nga një zonë e rrezikuar, **duhet** të shkoni menjëherë në karantinim në shtëpi dhe të lajmëroni qytetin e Mannheim-it! Ju lutemi menjëherë të dërgoni një E- Mail në:

[31corona@mannheim.de](mailto:31corona@mannheim.de)

[ Në E-Mail duhet të shënohen **të gjithë** personat e familjes suaj / me familje e katandi që kanë hyrë në vend: me emrat, datën e lindjes, datën e hyrjes në vend, eventualisht numrin e fluturimit, nga cili vend/cilat shtete jeni kthyer dhe ku keni qëndruar 14 ditë para hyrjes në vend.

Qyteti i Mannheim-it ka nevojë për adresën e juaj të E- Mail-it, adresën e juaj të vendbanimit (ku do të kalohet karantina) dhe nëse është e mundur, një numër telefoni në mënyrë që të mund t'ju kontaktojnë shpejt.

### 2. KU DHE SI MUND TË TESTOHENI?

Urdhëresa i obligon udhëtarët hyrës nga zonat e rrezikuara, që të bëjnë një test për Coronën kur hyjnë në Gjermani. Në mënyrë alternative udhëtarët, që hyjnë në vend mund të paraqesin një rezultat negativ të testimit, i cili nuk duhet të jetë më i vjetër se 48 orë.

Testi duhet të jetë bërë në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose në një laborator tjetër të listuar nga Instituti Robert Koch nën adresën [www.rki.de/covid-19-tests](http://www.rki.de/covid-19-tests). Vërtetimi i testit duhet të jetë i përpiluar në gjuhën gjermane ose në anglisht.

Formulimin e saktë të urdhëresës për obligimin e kryerjes së testimit të udhëtarëve, që hyjnë nga zonat e rrezikuara ju e gjeni nën

**AKTUALISHT UDHËTARËVE, QË HYJNË NGA ZONAT E RREZIKUARA  
U OFROHEN TESTIME FALAS:**

Q▪

- Qendra testimi me teste falas në të gjitha aeroportet.
- Qendra testimi në disa stacione treni (për shembull Stuttgart)
- Qendra testimi në lokalet e ndryshme të pushimit në autostradat pas pikave të kalimeve kufitare.
- Ndëmjetësim i terminave tek mjekët përmes Shoqatës së Mjekëve të Sigurimeve Shëndetësore Ligjore/ Kassenärztliche Vereinigung:  
Tel: 116117 (pa prefiks)
- Për udhëtarët (shtetas jo gjerman ose personat, që nuk banojnë në Gjermani), të cilët hyjnë në Gjermani, NJË testim falas nuk është i garantuar. (Shpenzimet e shkaktuara duhet të përballohen vetë nga ata)
- Qendra e testimit në Klinikën e Mannheim -it është vetëm për personat me simptoma.

Pavarësisht nga një test i kryer, patjetër ju duhet të lajmëroheni tek autoriteti lokal [31corona@mannheim.de](mailto:31corona@mannheim.de) , pas rihyrjes në vend nga një zonë e rrezikuar!

Informacione të mëtejshme aktuale në gjuhë të ndryshme mund t'i gjeni gjithashtu në faqen kryesore të internetit (Homepage) të qytetit të Mannheim-it nën

<https://www.mannheim.de/de/informationen-zu-corona/informationen-in-verschiedenen-sprachen>

**Kujdesuni për veten dhe të tjerët dhe qëndroni të shëndetshëm!**